

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Gjykata Speciale - Rexhep Selimi dënohet me 13 vjet burgim
ADRESA	https://www.syri.net/politike/917014/rexhep-selimi-denohet-me-13-vjet-burgim/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 09:49:58 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 09:47:09 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e237932157f729705e340b2a9a6739a74ee31a302cdf3d1de29bac36f4f73145
TEKSTI	a4c9e1ff9f0432cf2cfeb863ff89d3e51d99677753588f687ff1821e7db994c41
PAMJA	63ef232a1b082d555a567e56dbfc9809755f86278704fc9d48c9324e473ed10e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	85a28e8ceb20e5ff9eb8bf9ca3e836e3e5a87edb33fee5ff70fef780db10156e
E MËPARSHMJA	943425a0d7e90dde2baad172209c8a086ca5720907c8dbf99672a01843012541
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/85a28e8ceb20e5ff9eb8bf9ca3e836e3e5a87edb33fee5ff70fef780db10156e>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



NDRIÇIM KULLA
Gjuha si brushë dhe ironia si armë e Edi Ramës



IRENA BEQIRAJ
Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!

LAJMI I FUNDIT

LIVE - Hagë, jepet vendimi, ish-krerët e UÇK-së dënohen me 81 vite heqje lirie! Marshim e indinjatë



më të lexuarat

Zhupa: Nga shkollat me turne te emigrimi i të rinjve, problemet mbeten të njëjta, fëmijët paguajnë çmimin


Specialja: Të akuzuarit vepruan së bashku për një qëllim të përbashkët kriminal, Thaçi ishte anëtar kyc

'Mafia emëron ministrat në qeverinë Rama', Kepi: E kanë të lehtë të gjejnë personin e duhur për aferat e tyre

'Thaçi kishte dijeni për krimet, Veseli mori pjesë dhe inkurajoi kryerjen e tyre'

Muzeu hebraik në Vlorë/ Nezini: Godina i përket Klubit Labëria, po zhduket historia

PD: Shpopullimi i Shqipërisë, një krizë që po zbraz vendin dhe po rrezikon të



Rexhep Selimi dënohet me 13 vjet burgim

11:47, 16/09/2026

ZMADHO TEKSTIN

Rexhep Selimi është dënuar me 13 vjet burgim nga Dhomat e Specializuara në Hagë. Trupi gjyqësor e shpalli Selimin fajtor për krime lufte, përfshirë trajtimin mizor, torturën dhe vrasjen e paligjshme.

Selimi është shpallur fajtor për pikën 3 të aktakuzës, për arrestim dhe ndalim të paligjshëm ose arbitrar, si krim lufte, të kryer kundër së paku 385 personave.

Ai është shpallur gjithashtu fajtor për trajtim mizor ndaj së paku 49 personave, torturë ndaj së paku 303 personave dhe vrasje të paligjshme të së paku 96 personave.

Për këto vepra penale, trupi gjyqësor ka caktuar dënime të veçanta: gjashtë vjet burgim për arrestimin dhe ndalimin e paligjshëm ose arbitrar, dy vjet për trajtimin mizor, tetë vjet për torturën dhe 11 vjet për vrasjen e paligjshme.

Pas përcaktimit të dënimeve individuale, trupi gjyqësor ka shqiptuar dënimin e njëjësuar prej 13 vjetësh burgim për sjelljen kriminale në tërësi. Në këtë dënim llogaritet edhe koha që Selimi ka kaluar në paraburgim.

Trupi gjyqësor e ka shpallur Selimin të pafajshëm për një numër incidentesh të krimeve të luftës, me arsyetimin se ato nuk u vërtetuan përtej dyshimit të arsyeshëm, se disa akuza u përfshinë në një akuzë më konkrete ose se incidentet nuk përfshiheshin në juridiksionin e gjykatës.

Selimi është shpallur gjithashtu i pafajshëm për krimet kundër njerëzimit të përndjekjes, burgosjes, akteve të tjera çnjerëzore, torturës, vrasjes së paligjshme dhe zhdukjes me forcë, sipas pikave 1, 2, 4, 6, 8 dhe 10 të aktakuzës.

Sipas gjykatësit Charles Smith, Selimi ishte anëtar i tre grupesh të UÇK-së dhe anëtar i Shtabit të Përgjithshëm. Ai kishte shërbyer edhe si shef i Drejtorisë Operative dhe Inspektor i Përgjithshëm.

Trupi Gjyqësor ka konstatuar se Selimi luajti rol thelbësor në krijimin e zonave operative dhe njërive të UÇK-së. Sipas Smithit, ai i inspektoi rregullisht këto zona dhe mernte raporte për persona të dyshuar dhe kolaboracionistë.

Sipas konstatimeve, Selimi ishte në dijeni se njësitë e UÇK-së, për të cilat ishte përgjegjës t'i inspektonte, po shënjestronin persona të dyshuar dhe kolaboracionistë.

Smith ka thënë se Selimi mori pjesë në arrestimin dhe ndalimin e 13 parlamentarëve në Qirez dhe ishte i pranishëm në disa prej vendeve të krimeve të përfshira në aktakuzë.

Trupi Gjyqësor ka konstatuar gjithashtu se Selimi kishte dijeni për një numër të konsiderueshëm krimesh, por nuk ndërmori hapa për parandalimin, hetimin ose ndëshkimin e tyre.

Sipas Smithit, në një rast Selimi ndërhyri personalisht për lirimin e katër pjesëtarëve të UÇK-së të ndaluar për krijimin e një qendre të paligjshme ndalimi.

© SYRI.net

Lexo edhe:



Elshani: Situatë e qetë në veri, Policia e gatshme të reagojë në rast incidentesh



Audiopërgjimi i Ahmetajt/ Reagon shoqëria DEL-CNG SHPK



Zgjerimi i Bllokut/ Von der Leyen: Duhet të shikojmë drejt Ballkanit Perëndimor, procesi i bazuar në meritë

Ardhmen e tij



Urimi dhe mesazhi i Metës: PISA janë një tjetër dëshmi e gjendjes alarmante të shkollave! Për PL-në arsimit prioritet



'Selimi dha kontribut në zbatimin e qëllimit të përbashkët kriminal, mori pjesë në kryerjen e krimeve'



Ngërçi me pagat/ Gjykata e Kukësit mbyll dyert për qytetarët 3 ditë

TË NGJASHME



Dënimi i ish krerëve të UÇK-së/ LDK: Djemtë dhe vajzat e UÇK-së mbrojtën prapen e shtëpisë



VIDEO - FOTO/ Pamje tronditëse nga trazirat në Hagë, mediat: Demonstrata doli jashtë kontrollit



Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së në ballinat e mediave kryesore botërore



Organizata e Veteranëve të Luftës: UÇK s'ka qenë kurrë ndërmarrje kriminale



Vetrani i luftës shpërthen në lot, Pllashniku: Është padrejtësi, Ballkani t'i dijë mirë pasojat



Gucati: Nuk duhet t'i humbim shpresat, mbetet apeli



Albulena Haxhiu: Dënimet janë goditje e rëndë, fjala e fundit juridike nuk është thënë

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË-STIL TRASHËGIMI MEDIËS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net